

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.25.08.2023*

**25.08.2023
Ora 12:09**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Mbi përdorimin e portalit elektronik (modulit) për partitë politike dhe subjektet zgjedhore”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
 - **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
 - **Stafi KQZ: Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike: S’ka prezent!**
- **Të tjerë: KRIIK**

Z. I. Celibashi: Mirëdita! Në seancën e sotme publike kemi në rendin e ditës disa çështje. Miratimin e disa projektvendimeve që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës.

- Projektvendimi që lidhet me miratimin e materialit zgjedhor që do të përdoren për këto zgjedhje;

- miratimin e sasisë së fletëve të votimit që do të prodhohen;


- miratimin e sasisë së vulave rezervë, si dhe:

- projektvendimi “Mbi përdorimin e portalit elektronik (modulit) për partitë politike dhe subjektet zgjedhore”.

Fillojmë me këtë pikë të rendit të ditës! Po Valbona!

Znj. V. Ballgjini: Në zbatim të neneve 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, 63, 64, 65, 67, 70 të Kodit Zgjedhor, është hartuar projektvendimi “Mbi përdorimin e portalit elektronik (modulit) për partitë politike dhe subjektet zgjedhore”. Objekt i këtij

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.25.08.2023*

projektvendimi është përfitimi, administrimi dhe ruajtja nga KQZ e të dhënave mbi partitë politike dhe subjektet zgjedhore, nëpërmjet Portalit Elektronik për Partitë Politke. Nëpërmjet kësaj platforme do të përcaktohen:

- Mënyra e ngarkimit të të dhënave të partive në këtë portal;
- Kërkesa për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor, për të propozuar anëtarë të komisioneve zgjedhore, të grupeve të numërimit, vëzhgues, apo kërkesa të do të paraqiten dhe të shqyrtohen nëpërmjet portalit;
- Rregullat dhe përfitimi, administrimi dhe ruajtja e të dhënave për partitë politike, subjektet zgjedhor, për regjistrimin e tyre nëpërmjet platformës, si dhe mbi shqyrtimin e kërkesave të ndryshme nëpërmjet platformës.

Ky projektvendim shoqërohet gjithashtu dhe me manualin e përdorimit. Bashkëlidhur keni projektvendimin.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Mirë atëherë, miratojmë këtë projektvendim, i cili me siguri do të jetë një shërbim i mirë për partitë politike, në lidhje me raportin komunikues me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Nga ana tjetër dhe për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për të ndërtuar një sistem të administrimit të të dhënave që lidhen me partitë politike dhe me subjektet zgjedhore, në mënyrë të tillë që jo vetëm do të rrisë nivelin e transparencës, por në të njëjtën kohë dhe integritetin e këtyre të dhënave. E miratojmë projektaktin sipas draftit të paraqitur.

Ndërkohë miratojmë edhe tre projektvendimet e tjera të cilat lidhen me:

- materialet zgjedhore që do të përdoren për këto zgjedhje që do të jenë ato të zgjedhjeve të 14 majit 2023;
- miratojmë edhe projektvendimin që lidhet me miratimin e sasisë së fletëve të votimit, si dhe:

*Zbardi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.25.08.2023*

projektvendimin që lidhet me miratimin e sasisë së vulave rezervë të komisionit të qendrës që votimit.

Mirë, çështje të tjera nuk kemi, faleminderit! Seanca mbyllet!

Vendimi nr. 731, 732, 733, 734

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

